

Vendim nr. 214 datë 02.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 02.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (R) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: RENATO ZALLEMI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2018-2637 (222), datë 19.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 129, datë 02.11.2018 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 2024-00-558, datë 04.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 35, datë 04.03.1997, ka deklaruar fajtor kërkuesin Renato Zallemi për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Armëmbajtja pa leje”, të parashikuara nga nenet 78, paragrafi i dytë dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*) dhe bazuar në nenin 56 të këtij kodi e ka dënuar atë përfundimisht, në

bashkim të dënimeve, me burgim të përjetshëm. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 110, datë 08.10.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 230, datë 07.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

2. Lidhur me çështjen e kërkuarit është dënuar edhe shtetasi G.L. për veprën penale “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuar nga neni 302 i KP-së, me vendimin nr. 157, datë 15.06.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

3. Kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), me të cilin kundërshtonte procesin penal në ngarkim të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 65, datë 29.03.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për shkak të paraqitjes së ankimit jashtë afatit ligjor.

4. Më shumë se 14 vjet pas përmbylljes së procesit të gjykimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tij, kërkuari i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, në bazë të nenit 450, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me arsyetimin se faktet e vëna në themel të vendimit për dënimin e tij nuk pajtoheshin me faktet e vëna në themel të vendimit për dënimin e shtetasit G.L., duke pasur këto të fundit një ndikim thelbësor për zgjidhjen e drejtë të çështjes nga gjykata, pasi do të lehtësonin pozitat e kërkuarit për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2018-2637 (222), datë 19.07.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, pasi faktet e pretenduara nga kërkuari nuk janë konsideruar si determinante dhe as baza ku është mbështetur provueshmëria e kryerjes së veprës penale në ngarkim të kërkuarit. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 129, datë 02.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2024-00-558, datë 04.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

6. Në datën 31.07.2024 kërkuari, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të sipërcituar. Ankimi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 dhe është regjistruar përfundimisht në datën 15.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial*, pasi vendimet e gjykatave janë të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin. Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar padrejtësisht faktet që vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën, si jo determinante për provueshmërinë e kryerjes së veprës penale, për më tepër që ajo duhej të shprehej vetëm për miratimin ose jo të kërkesës për rishikim. Ato fakte nuk kanë të bëjnë vetëm me marrëdhëniet e të dënuarve midis tyre, siç shprehet gjykata, por faktojnë se gjykata nuk ka asnjë provë për të vërtetuar se kjo veprë është kryer me paramendim dhe për interes, çka përbën gabim të gjykatës dhe nuk i përgjigjet të vërtetës dhe rëndojnë pozitën e kërkuetit, i cili në fakt e ka kryer veprën në kushtet e vetëmbrojtjes. Ajo gjykatë shprehet për pamundësinë e vlerësimit të provave të sjella nga kërkueti, me pretendimin se nuk ia lejon ligji për atë lloj gjykimi. Edhe gjykata e apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit procedural e material penal, duke ngatërruar edhe bazën ligjore ku është bazuar kërkueti, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është një vendim standard.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e

ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kolegji vëren se në përmbajte të ankimit kushtetues individual kërkuesi ka parashtruar pretendime si për procesin e themelit të përfunduar me vendimin e datës 07.05.2004 të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe për zbatimin e nenit 450 e vijues të KPP-së të lidhur me mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të kërkuesit.

10. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes është i datës 07.05.2004. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës

në datën 31.07.2024 (data e shërbimit postar), pasi Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 2024-00-558, datë 04.04.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 35, datë 04.03.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

15. Në vlerësimin e Kolegjit, paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor 4–muajor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Kolegji mban në konsideratë faktin se kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor.

16. Për më tepër, Kolegji vlerëson se në paraqitjen e ankimit kushtetues individual me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët nuk mund të pretendojnë të parashtrajnë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor, si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj.

17. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se për pjesën e argumenteve të kërkuarit në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual të lidhur me procesin e gjyqimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tij, ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000. Ndërsa, për pretendimet e parashtruara nga kërkuari që lidhen me procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, Kolegji vlerëson ato janë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, për pjesën e mbetur të pretendimeve të kërkuarit, Kolegji vëren se ai e ka lidhur pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial, me zbatimin e nenit 450 e vijues të KPP-së nga gjykatat. Sipas kërkuarit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kanë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat për rishikimin e vendimit, pasi ato i kanë vlerësuar padrejtësisht faktet që vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën si jo determinante për provueshmërinë e kryerjes së veprës penale, për më tepër që ato duhej të shpreheshin vetëm për miratimin ose jo të kërkesës për rishikim. Në zbatim të gabuar të këtyre dispozitave, ato janë shprehur për pamundësinë e vlerësimit të provave të sjella nga kërkuari, me pretendimin se nuk ia lejonte ligji për atë lloj gjykimi, ndërsa gjykata e apelit, sipas kërkuarit, ka ngatërruar edhe bazën ligjore ku është bazuar kërkesa për rishikim.

19. Kolegji thekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këndvështrim të këtij standardi, Kolegji konstaton se pjesa e pretendimeve të kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të lidhur me të drejtën e aksesit substancial, për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit, nga përmbajtja dhe thelbi i tyre janë më tepër të natyrës ligjore dhe kanë të bëjnë me çështje të zbatimit të ligjit dhe vlerësimit të provave, dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Edhe për pretendimin e ndërlidhur të kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial, Kolegji vëren se ai nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues në mbështetje të këtij pretendimi, për rrjedhojë nuk mund të bëhet objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë.

21. Si përfundim, bazuar në arsytimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.